



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri
Tel: 00 355 42240978
info@ukt.al
NIPT J620050020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e operatorëve ekonomik **“Kupa” sh.p.k. & “Kola Invest” sh.p.k** përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 189 rep. dhe nr.53/1 kol., nga shoqëria **“Kupa” sh.p.k**, me nr. NIPT-i K51615512C, me administrator Z.Shkëlqim Kupa, me adresë: Rruga Berisha, Argjijnatura me nr.pasurie 482, Çerkeze.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim rrjet kanalizimi në zonën e ish Uzinës Autotraktori”

Fondi Limit: 34,869,799 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjetillës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja e realizimit të punimeve: 60 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Data e zhvillimit të tenderit është: 05/07/2016 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.24 të dates 20/06/2016

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“Shendelli” sh.p.k**, NIPT K07924803N
Vlera: **nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**
2. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“Boshnjaku-B” sh.p.k** NIPT K72627402H
& **“Shendelli” sh.p.k**
Vlera: **28,240,838** (njëzet e tetë milion e dyqind e dyzet mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik **“BE-IS” sh.p.k**, NIPT K37327201H
Vlera: **31,235,539** (tridhjetë e një milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik **“Gjiguria” sh.p.k**, NIPT J62903456H
Vlera: **31,340,729** (tridhjetë e një milion e treqind e dyzet mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.
5. Operatori ekonomik **“ED Konstruksion” sh.p.k**, NIPT K61625001I
Vlera: **34,511,820** (tridhjetë e katër milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa TVSH.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J62005002O

6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Kupa” sh.p.k. NIPT K51615512C
& ”Kola Invest” sh.p.k
Vlera: **33,550,650**(tridhjetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “Shendelli” sh.p.k, me nr. NIPT-i K07924803N, me administrator Z.Yzedin Bozhaj, **i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.**
2. Bashkimi i operatorëve ekonomik **“Boshnjaku-B” sh.p.k & ”Shendelli” sh.p.k**përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 1127 rep. dhe nr.522 kol., nga shoqëria “ Boshnjaku-B” sh.p.k, me nr. NIPT-i K72627402H, me administrator Z.Bashkim Dulla, me ofertë ekonomike me vlerë prej **28,240,838**(njëzet e tetë milion e dyqind e dyzet mijë e tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, i cili **ka** mangësi në dokumentacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimi/Kualifikimit si më poshtë:
 - Ne tenderin me objekt: “Ndërtim rrjet kanalizimi në zonën e ish Uzinës Autotraktori”, shoqëria “BOSHNJAKU-B” sh.p.k. ka hyrë në bashkëpunim me shoqërinë “SHENDELLI” sh.p.k., ku dhe për të njëjtin tender shoqëria “SHENDELLI” sh.p.k. ka konkurruar gjë e cila bie në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.
 - Nuk ka paraqitur analize cmimesh kriter i vendosur ne piken **2.3.10 të DST.**
 - Kontratat e furnizimit me beton të paraqitura në tender nuk janë të paisuara me vërtetim OSHEE, që ka likujduar faturat e maturuara të energjisë elektrike.
 - Nuk ka paraqitur nje deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se inxhinieret e deklaruar ne kerkesen 2.3.4 per kualifikim jane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate dhe nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.
3. Operatori ekonomik **“BE-IS” sh.p.k**, me nr. NIPT-i K37327201H, me administrator Z. Besnik Çamer (Veliu), me ofertë ekonomike me vlerë prej **31,235,539**(tridhjetë e një milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i cili **ka** mangësi në dokumentacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimi/Kualifikimit si më poshtë:
 - Inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4 për kualifikim të DST nuk janë të disponueshëm për realizimin e kesaj kontrate pasi janë të angazhuara në kontrata të tjera, konkretisht në kontratat e lidhura me autoritetin Kontraktor UKT sha të cilat janë si më poshtë vijon:
 - “Rikonstruksion i linjës Ø 426mm çelik nga Rr.Mustafa Demiri deri tek Kryqëzimi i Rr.Elbasanit; Rikonstruksion i linjës së Kombinatit Ø 426mm çelik nga Rr.Besnik Sykja deri tek Kryqëzimi i Rr.Elbasanit”
Loti 1:Nga piketa “V-1” deri në piketën “V-15”



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J620050020

- “Rikonstruksion i linjës Ø 426mm çelik nga Rr.Mustafa Demiri deri tek Kryqëzimi i Rr.Elbasanit; Rikonstruksion i linjës së Kombinatit Ø 426mm çelik nga Rr.Besnik Sykja deri tek Kryqëzimi i Rr.Elbasanit”

Loti 2:Piketa "1"÷"18"; "V16"÷"18"

- “Ndërtim Rrjet Ujësjetës në Zonën që kufizohet nga rrugët, Myslym Keta, Shefqet Kuka dhe Rr. Thoma Filipeu”

Në analizat e çmimeve të paraqitura për justifikimin dhe argumentimin e zërave të punimeve çmimi i zërit të punimeve për puntoritë është paraqitur me 115 dhe 125 lekë ora, ku në mbështetje të Vendimit të K.P.P. 316/2014 dhe VKM nr. 573, datë 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, përcaktohet shprehimisht: “Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzet e dymijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”. Pra, duke qenë se paga orare minimale duhet të jetë 127 lekë, llogaritjet e bëra në analizat e kostove të bashkimit të mësipërm të operatoreve ekonomike për pagën orare në masën 125 lekë, bien në kundërshtim me vendimin e mësipërm. Gjithashtu mbështetur në Mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë neni 83 ku përcaktohet shprehimisht: “Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë pune në javë.”

- Viti ka 365ditë / 7 ditë (javë) =52.1 javë ka viti.
- 52.1 javë x 40 orë pune =2085.7 orë në vit.
- 2085.7 orë në vit / 12 muaj = 173.8 orë në muaj
- 22000 lekë paga minimale / 173.8 orë në muaj punë = 126.6 lekë në orë në ditë.

4. Operatori ekonomik “**Gjiguria**” sh.p.k, me nr. NIPT-i J62903456H, me administrator Z.Milo Gjiguria dhe Z.Florenc Gjiguria, me ofertë ekonomike me vlerë prej 31,340,729 (tridhjetë e një milion e treqind e dyzet mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, i cili ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimit/Kualifikimit si më poshtë:

- Nuk ploteson kriterin e vendosur ne piken 2.1.2 i cili sanksionon: Vërtetim lëshuar nga Komuna ose Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2015,2016 si për NIPT-in kryesor ashtu edhe për NIPT-et sekondare.
- Nuk ploteson kriterin e vendosur ne piken 2.3.12 i cili sanksionon: OE duhet te paraqese Kontrate furnizimi betoni e cila te jete e shoqëruar me: lejen e ndërtimit dhe autorizim mjedisor (leje) për aktivitetin: Impiant prodhim betoni (QKL Kodi:III.1.B) si dhe vërtetim nga OSHEE që ka likuaduar faturat e maturuara të energjisë.

- Në analizat e çmimeve të paraqitura për justifikimin dhe argumentimin e zërave të punimeve çmimi i zërit të punimeve për puntoritë është paraqitur me 110 lekë ora, ku në mbështetje të Vendimit të K.P.P. 316/2014 dhe VKM nr. 573, datë 3.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, përcaktohet shprehimisht: “Paga bazë minimale, mujore, për



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J62005002O

punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzet e dymijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”. Pra, duke qenë se paga orare minimale duhet të jetë 127 lekë, llogaritjet e bëra në analizat e kostove të bashkimit të mësipërm të operatoreve ekonomike për pagën orare në masën 125 lekë, bien në kundërshtim me vendimin e mësipërm. Gjithashtu mbështetur në Mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë neni 83 ku përcaktohet shprehimisht: “Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë së 40 orë pune në javë.”

- Viti ka 365ditë / 7 ditë (javë) =52.1 javë ka viti.
- 52.1 javë x 40 orë pune =2085.7 orë në vit.
- 2085.7 orë në vit / 12 muaj = 173.8 orë në muaj
- 22000 lekë paga minimale / 173.8 orë në muaj punë = 126.6 lekë në orë në ditë.

5. Operatori ekonomik **“ED Konstruksion” sh.p.k**, me nr. NIPT-i K61625001I, me administrator Z.Alfred Ibrahim, me ofertë ekonomike me vlerë prej **34,511,820**(tridhjetë e katër milion e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa TVSH, i cili ka mangësi në dokumentacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimit/Kualifikimit si më poshtë:

- Nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar se plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit/kualifikimit të përcaktuara në shtojcën 8-të, të dokumentave të tenderit me objekt: “Ndërtim rrjet kanalizimi në zonën e ish Uzinës Autotraktori”

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomik **“Kupa” sh.p.k. & “Kola Invest” sh.p.k** përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 189 rep. dhe nr.53/1 kol., nga shoqëria “Kupa” sh.p.k, me nr. NIPT-i K51615512C, me administrator Z.Shkëlqim Kupa, me adresë:Rruga Berisha, Argjijnatura me nr.pasurie 482, Çerkeze, me ofertë ekonomike me vlerë prej **33,550,650**(tridhjetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, se është **identifikuar si oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.07.2016.



Adresa: Rruga 5 Maji, Tiranë, Shqipëri

Tel: 00 355 42240978

info@ukt.al

NIPT J620050020

Ankesa: nuk ka patur

